




01-461



Në bazë të nenit 21, 22, 44 dhe 84 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-66508/22 dt. 24.03.2022, të kërkuarit Haki Cenaj, nga fshati Lloçan, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për dy ndërtesa shtëpi të banimit individual, të ndërtuara në kuadër bllokut urban “L-24”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 14.06.2023, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET kërkuarit Haki Cenaj, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-66508/22 dt. 24.03.2022, përdorimi i dy ndërtesave shtëpi të banimit individual me etazhitet B+P+2ET, të ndërtuara sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-78889/17 dt. 11.01.2018, në kuadër të bllokut urban “L-24”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë konkretisht në parcelat ndërtimore nr. 299-2 dhe 300-14, ZK. Çagllavicë.

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugët “Agim Çavderbasha” ku ka dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numër: 40 dhe “Haxhi Hoti” ku ka dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numër: 33 në Prishtinë, dhe të njëjtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave në evidencat e regjistrit kadastral.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Kërkuarisi Haki Cenaj, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-66508/22 dt. 24.03.2022, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për dy ndërtesa shtëpi banimi individual me etazhitet B+P+2ET, në Prishtinë, të ndërtuara në kuadër të bllokut urban “L-24”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” konkretisht në kuadër te parcelave kadastrale nr. 299-2 dhe 300-14, ZK. Çagllavicë, sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-78889/17 dt. 11.01.2018, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Njoftim lidhur me kërkesën për inspektim final", me referencë 09 Nr. 391/02-175767/21 dt. 11.02.2022, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njoftimit mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografitë gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat;

Raportin e përfundimit të punëve, nga udhëheqësi i vendpunishtes Florian Ujkani; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Vigan Etemi; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Leonard Sinani; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjetillësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Faton Gashi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Visar Rexhepi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Gazmend Shala; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga kompania e licencuar "N.E.W.S" Sh.p.k. për matje gjeodezike me numër të licencës 22;

Drejtoria e Urbanizimit, pas pranimit të kërkesave të ndara 05 Nr. 391/02-66508/22 dt. 24.03.2022 dhe 05 Nr. 391/02-66520/22 dt. 24.03.2022, për pajisje me Certifikatë të Përdorimit për dy ndërtesave shtëpi të banimit individual me etazhitet B+P+2ET, shqyrtimit të përmbajtjes së tyre dhe konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi, duke u mbështet në paragrafin 1. të nenit 84 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku thuhet se, citojmë: "Organi publik kompetent mund të bashkoj disa procedura administrative në një të vetme nëse të drejtat dhe detyrimet e palëve të përfshira bazohen në një gjendje faktike dhe bazë juridike të njëjtë apo të ngjashme", vendosi ti bashkojë dhe trajtojë në një procedurë të vetme administrative, duke u bazuar në faktin se të dy kërkesat kanë të bëjnë me Certifikatën e Përdorimit për dy ndërtesat shtëpi banimi individual të cilat janë pajisur me një Vendim të Lejes Ndërtimore me numër 05 Nr. 351/02-78889/17 dt. 11.01.2018.

Pas këtij konstatimi dhe veprimi juridik, kjo drejtori mori në shqyrtim kërkesat e referuara më lartë, dhe pas konsultimit të dokumentacionit të bashkëngjitur, konstatoi si në vijim:

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjetillësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht dy ndërtesave shtëpi të banimit individual mund të përdoren.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesat e banimit individual shtëpi banimi mund të përdoren, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat banimit individual-shtëpi banimi.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-66508/22 DT. 14.06.2023**

Zyrtari,
Berim Osmanaj

Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi

Drejtori,
Arber Sadiki

